



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

Departamenti Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: [klsh.org.al](mailto:klsh.org.al); eb-site [.klsh.org.al](http://klsh.org.al)

Nr. 937/\_\_\_Prot

Tiranë, më \_\_\_\_\_. 2018

**V E N D I M**

**Nr.175, Datë 27/11/ 2018**

**P Ë R**

**AUDITIMIN TEMATIK TË USHTRUAR NË BASHKINË DEVOLL**

Nga auditimi tematik i ushtruar në Bashkinë Devoll, rezultoi që veprimtaria sipas objektit të autorizimit përputhet në përgjithësi me kërkesat dhe kriteret e kuadrit rregullator në fuqi përveç disa të metave dhe dobësive me pasoja financiare në drejtim të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave për punë publike.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

**VENDOSA:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit Tematik të ushtruar në Bashkinë Devoll, sipas Autorizimit për verifikim dokumentacioni Nr. 937, datë 07.08.2018, të miratuar nga Kryetari i KLSH.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

**A. MASA ORGANIZATIVE :**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe i dokumentacionit teknik të zbatimit të kontratës "Ndërtimi i pilave të urës tip "BAILY" në lumin Devoll, njësia administrative Miras" të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Devoll dhe Operatorit Ekonomik (OE) [REDACTED] SHPK, u konstatua se: Edhe pse janë rehabilituar punimet për ndërtimin e pilës të urës tip "Baily" nga zbatuesi i punimeve duke siguruar lëvizje normale të automjeteve dhe këmbësorëve, nga zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve nuk janë bërë azhurnimet dhe rakordimet për sa i përket projektit të zbatimit të ndryshuar dhe pasqyrimit të dimensioneve reale mbas riparimit të defekteve në librezën e masave.

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Devoll t'i kërkojë Operatorit Ekonomik (OE) [REDACTED] SHPK, të marrin masa për kryerjen e azhurnimit të projektit të zbatimit, sipas faktit si dhe plotësimin e librezës së masave me dimensionet reale pas rehabilitimit të punimeve të "Pilës" në krahun e majtë të urës. Të vendoset tabela me aftësinë mbajtëse të urës.

**Deri më 31.12.2018**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe dokumentacioni teknik të kontratës me objekt "Rehabilitimi i kanalit ujitës të fushës së Bilishtit, Kanali Bracanj - Vishocicë", të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Devoll dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik (BOE) [REDACTED] SHPK përfaqësues nga OE [REDACTED] SHPK u konstatua se projekti i zbatimit ka pësuar ndryshime në kanalën sekondar dhe kryesor nga seksioni 85 deri tek seksioni 162 sepse ky segment kalon nëpër pronat private dhe duke qenë se shpronësimi i tokave është i pamundur për shkak të mungesës së fondeve, si zgjidhje është menduar ridimensionimi i këtyre dy segmenteve të kanalit, pa prekur anën funksionale të projektit dhe qëllimin e investimit, duke zvogëluar seksionin tërthor të kanalit.

Situacioni pjesor është hartuar dhe likuiduar pa u miratuar më parë projekti i zbatimit dhe preventivi, veprim ky në kundërshtim me UM Nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar dhe me kontratën dy palëshe të lidhur.

**2.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Devoll dhe zbatuesi i punimeve shoqëria [REDACTED] SHPK, të marrin masa për miratimin e projektit të zbatimit të azhurnuar për kanalën kryesor dhe sekondar dhe të gjithë objektin duke bërë përputhjen dhe rakordimin edhe me projekt-preventivin. Të rishikohet preventivi sipas projektit të ndryshuar dhe të plotësohet me zërat e punimeve që mungojnë si, p.sh "Priza 40x40 me barazh në kanalën kryesor". Gjithashtu situacioni pjesor në vijim të likuidohet vetëm pasi të jenë miratuar projekti i zbatimit dhe preventivi i ndryshuar.

**Deri më 31.12.2018**

**3. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Devoll nuk ka funksionuar në bazë strategjish periodike dhe objektiva prioritar. Nga auditimi dhe komunikimi me subjektin rezulton se në Bashkinë Devoll nuk janë parashikuar plane vjetore dhe operacionale aktivitetesh për realizimin e objektivave por ndjekja e realizimit të detyrave dhe përgjegjësive të përshkruara në rregulloren e brendshme si dhe monitorimi e raportimi funksionojnë në mënyrë operative si dhe nuk ka aplikuar metodën e vlerësimit dhe menaxhimit të risqeve që kërcënojnë realizimin e objektivave dhe respektivisht realizimin e funksioneve kryesore të ngarkuara sipas kuadrit rregullator në fuqi. Nga auditimi i evidencës së grumbulluar, raportimet e nivelit drejtues dhe përgjigjet e stafit të administratës në pyetësorët e aplikuar për këtë qëllim rezulton se nuk janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe veçanërisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

**3.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Devoll, në ushtrim të përgjegjshmërisë menaxheriale të institucionit që drejton, të formojë një grup pune me specialistë me njohuri të spikatura profesionale me qëllim që:

a) Të organizojë punën për vlerësimin e situatës aktuale të veprimtarisë së bashkisë identifikimin e dobësive, kërcënimeve dhe oportuniteteve dhe ndërtimin e strategjisë afatmesme e afatshkurtër të bashkisë duke marrë në konsideratë prioritetet e bashkisë në vijimësi.

b) Pas përfshirjes në strategji të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve profesionale si objektiv prioritar, të vlerësojë nevojat për trajnime të stafit kryesisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe të hartojë plane vjetore dhe operacionale aktivitetesh për realizimin e objektivave në tërësi dhe ato në fushën e trajnimeve në veçanti.

**3.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë nëpërmjet koordinatorit të riskut të ndërtojë një plan pune me detyra të mirë përcaktuara për të organizuar punën në bashki për aplikimin e funksionimit të institucionit me bazë vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në çdo nivel të administratës dhe dokumentimin në regjistrin qendror të riskut në vazhdimësi si rezultat i rishikimit dhe rivlerësimit të risqeve me qëllim garantimin e arsyeshem dhe në nivel sa më optimal të realizimit të objektivave dhe misionit të bashkisë.

Rekomandimet sa më sipër, në referencë të përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, neni 8, pika 8; neni 10; neni 16; neni 21; dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010.

**Deri më 31.12.2018**

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI:**

Bazuar në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b)-Të drejtat e KLSH- së, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e vlerës. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin me qëllim arkëtimin e **vlerës 366,935 lekë, si më poshtë:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës nr.35/38, prot., datë 14.08.2017, me objekt: “Ndërtimi i pilave të urës tip “BAILY” në lumin Devoll, njësia administrative Miras”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Devoll dhe Operatorit Ekonomik (OE) [REDAKTUAR] SHPK u konstatua se zërat e punimeve: Zëri 1 (3.68/1b) Gërmim themel (gropa) sip. 10-30 m<sup>2</sup> shkëmb, h=2.5 m, me makineri, prani uji për zgjerim rruge ; Zëri 3(3.624) Hidroizolim me emulsion dhe dy duar bitum; Zëri 5 (3.05) Shtresë binar dërrase, janë likuiduar për punime të pakryera dhe rritjen fiktive të çmimit për shpenzime makinerie dhe materiale për nën zërat (Kompresor + eksploziv + fitil + kapsol) në shumën **132,935 lekë** pa TVSH duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, nenit 8, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

**1.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Bashkia Devoll, që t’i kërkojë OE [REDAKTUAR] SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit arkëtimin e shumës **132,935 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës nr.35/38, prot., datë 14.08.2017, me objekt: “Ndërtimi i pilave të urës tip “BAILY” në lumin Devoll, njësia administrative Miras”.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës nr.1144/17 prot.,datë 10.07.2018 me objekt: “Rehabilitimi i kanalit ujitës të fushës së Bilishtit, Kanali Bracanj - Vishocicë”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Devoll dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik (BOE) [REDAKTUAR] SHPK përfaqësues nga OE [REDAKTUAR] SHPK, u konstatua se, “zëri 5 (2.258) nënshtresë zhavorri” është likuiduar për punime të pakryera në shumën 234,000 lekë pa TVSH duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, nenit 8, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

**2.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Bashkia Devoll, që t'i kërkojë BOE [REDACTED] SHPK & [REDACTED] SHPK përfaqësues nga OE [REDACTED] SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **234,000 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës nr.1144/17, prot., datë 10.07.2018, me objekt: “Rehabilitimi i kanalit ujitës të fushës së Bilishtit, Kanali Bracanj - Vishocicë”.

**Menjëherë**

## **B/1. PËRDORIM JO ME EFIKTIVITET, EFICENCË DHE EKONOMICITET I SHPENZIMEVE NË FUSHËN E PROKURIMEVE PUBLIKE.**

Në auditimin e procedurave të prokurimeve, të zhvilluara në Bashkinë Devoll, u konstatua se 5 procedura prokurimi janë kryer në kundërshtim me Nenin 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa a, b, d dhe dh, dhe Nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, Neni 23 “Specifikimet teknike”, Neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 27 “Kontratat e mallrave” pika 1 dhe 3, Nenin 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, nenin 24, “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe pika 5 e nenit 53, “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, për arsye se:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje automjete për nevojat e Bashkisë Devoll” e ndarë në 8 lote, me fond limit 18,500,000 lekë, zhvilluar në vitin 2018, rezultoi se: Vendosja e gabuar e specifikimeve teknike nga ana e komisionit të hartimit të specifikimeve teknike, të cilat nuk janë të lidhura ngushtë, nuk janë në përpjesëtim me objektin e kontratës objekt prokurimi dhe nuk janë të argumentuara me hollësi mbi domosdoshmërinë e tyre, duke i atribuar KVO kompetenca tej parashikimeve ligjore edhe mos plotësimi i kriterëve të vendosura në DST nga operatori ekonomik shpallur fitues duke shkaktuar mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve në vlerën totale të 5 loteve prej **13,083,330 lekë**, në 5 procedurat si vijon:

1. Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Blerje Fadrome per sherbimet Publike (loti 1)*”, Bashkia Devoll, me fond limit 4,166,666 lekë, zhvilluar në vitin 2018, fitues OE [REDACTED] shpk, me vlerë 4,166,000 lekë.
2. Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Blerje Kamion me tre Akse (loti 2)*”, Bashkia Devoll, me fond limit 4,166,666 lekë, zhvilluar në vitin 2018, fitues OE [REDACTED] shpk, me vlerë 4,166,000 lekë.
3. Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Blerje Automjet për Administratën (loti 3)*”, Bashkia Devoll, me fond limit 1,666,666 lekë, zhvilluar në vitin 2018, fitues OE [REDACTED] shpk, me vlerë 1,666,000 lekë.
4. Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Blerje Rimorkiator për shërbimet Publike (loti 6)*”, Bashkia Devoll, me fond limit 1,666,666 lekë, zhvilluar në vitin 2018, fitues OE [REDACTED] shpk, me vlerë 1,666,000 lekë.
5. Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Blerje Kamionçine për Pyjet (loti 7)*”, Bashkia Devoll, me fond limit 1,416,666 lekë, zhvilluar në vitin 2018, fitues OE [REDACTED] shpk, me vlerë 1,416,000 lekë.

**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Devoll nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të hartimit të kriterëve të paargumentuara, të kualifikimit e shpalljes fitues të operatorëve ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të miratuara në DST, të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative të pamatshme.

**Në vijimësi**

## **C. MASA ADMINISTRATIVE:**

### **c.1-Për Agjencinë e prokurimit publik.**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësi individuale të evidentuara dhe pasqyruara në Raportin përfundimtar të auditimit, mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me të metat e mangësitë e konstatuara, 8 punonjësve si më poshtë:**

1. -----, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të specifikimeve teknike në DST.
2. -----, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të specifikimeve teknike në DST.
3. -----, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të specifikimeve teknike në DST.
4. -----, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të specifikimeve teknike në DST.
5. -----, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të specifikimeve teknike në DST.
6. -----, në cilësinë e anëtarit të KVO.
7. -----, në cilësinë e anëtarit të KVO.
8. -----, në cilësinë e anëtarit të KVO.

**Për mos përdorim me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën 13,083,330 lekë** pasi nga auditimi i procedurave rezultuan probleme si kriteret për kualifikim janë të paargumentuara me volumet e punës sipas preventivit të publikuar, në kundërshtim me nenin 61, pika 2 e VKM 914. Në vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik pjesëmarrës u konstatua se në disa raste ata janë kualifikuar pa plotësuar kriteret e kërkuar në dokumentet e tenderit. Nga auditimi i procedurave të prokurimit në mënyrë analitike rezultuan shkelje, konkretisht si vendosje e gabuar e specifikimeve teknike nga ana e komisionit të hartimit të specifikimeve teknike, të cilat nuk janë të lidhura ngushtë, nuk janë në përpjesëtim me objektin e kontratës objekt prokurimi dhe nuk janë të argumentuara me hollësi mbi domosdoshmërinë e tyre, duke i atribuar KVO kompetenca tej parashikimeve ligjore, veprime këto, të cilat kanë sjell shmangie të konkurrencës referuar procedurës së prokurimit “Blerje automjete për nevojat e bashkisë Devoll” pasi të 8 lotet janë fituar nga i njëjti operator ekonomik. Veprimet e mësipërme kanë shkaktuar mos përdorim me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve në vlerën totale të 5 loteve 13,083,330 lekë, në 5 procedurat si vijon:

1. Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Blerje Fadrome për shërbimet Publike (loti 1)*”, Bashkia Devoll, me fond limit 4,166,666 lekë, zhvilluar në vitin 2018, fitues OE ----- shpk, me vlerë 4,166,000 lekë, trajtuar në faqen 9 të RPA.
2. Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Blerje Kamion me tre Akse (loti 2)*”, Bashkia Devoll, me fond limit 4,166,666 lekë, zhvilluar në vitin 2018, fitues OE ----- shpk, me vlerë 4,166,000 lekë, trajtuar në faqen 10 të RPA.
3. Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Blerje Automjet për Administratën (loti 3)*”, Bashkia Devoll, me fond limit 1,666,666 lekë, zhvilluar në vitin 2018, fitues OE ----- shpk, me vlerë 1,666,000 lekë, trajtuar në faqen 17 të RPA.
4. Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Blerje Rimorkiator për shërbimet Publike (loti 6)*”, Bashkia Devoll, me fond limit 1,666,666 lekë, zhvilluar në vitin 2018, fitues OE ----- shpk, me vlerë 1,666,000 lekë, trajtuar në faqen 18 të RPA.
5. Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Blerje Kamionçine për Pyjet (loti 7)*”, Bashkia Devoll, me fond limit 1,416,666 lekë, zhvilluar në vitin 2018, fitues OE ----- shpk, me vlerë 1,416,000 lekë, trajtuar në faqen 23 të RPA.

## **c.2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Devoll (IMTV)**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7 dhe 12 , Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, ndryshuar me Ligjin Nr. 183/2014, datë 24.12.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Devoll t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë në masën 50,000 lekë për 1 mbikëqyrës dhe 1 kolaudator** punimesh, si më poshtë:

**1. Z. [REDAKTUAR]** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, drejtues ligjor dhe teknik i shoqërisë [REDAKTUAR] SHPK dhe licencë MK. 2720/5, datë 24.07.2017, për shkeljet e konstatuara në 2 objektet si më poshtë:

**a.** Kontratë zbatimi me Nr. 35/38 Prot., datë 14.08.2017, me objekt: “Ndërtimi i pilave të urës tip “BAILY” në lumin Devoll, njësia administrative Miras”, Bashkia Devoll, me sipërmarrës punimesh Operatorin Ekonomik [REDAKTUAR] SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **132,935** lekë pa TVSH si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

**b.** Kontratë zbatimi me Nr. 1144/17, Prot., datë 10.07.2018 me objekt: “Rehabilitimi i kanalit ujitës të fushës së Bilishtit “Kanali Bracanj-Vishocicë” Bashkia Devoll”, me sipërmarrës punimesh Bashkimin e Operatorëve Ekonomik (BOE) [REDAKTUAR] SHPK përfaqësues nga OE [REDAKTUAR] SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **234,000** lekë pa TVSH si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

**2. Z. [REDAKTUAR]** në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në Kontratën e zbatimit me Nr. Prot. 35/38, datë 14.08.2017, me objekt: “Ndërtimi i pilave të urës tip “BAILY” në lumin Devoll, njësia administrative Miras” Bashkia Devoll, me sipërmarrës punimesh Operatorin Ekonomik [REDAKTUAR] SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **132,935** lekë pa TVSH si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore.*

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**